

VENDIM
Nr. 282, datë 8.5.2024

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AUTORITETIT PORTUAL Durrës

(Ndryshuar me VKM nr. 351, datë 13.5.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9, të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, “Për Autoritetin Portual”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Autoriteti Portual Durrës organizohet dhe funksionon sipas këtij statuti.
3. Vendimi nr. 596, datë 10.9.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij”, shfuqizohet.
4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti Portual Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

STATUTI I AUTORITETIT PORTUAL Durrës

Neni 1
Emërtimi dhe selia

Autoriteti Portual Durrës është person juridik, i cili organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, “Për Autoritetin Portual”, të këtij statuti dhe të legjislacionit në fuqi. Selia e Autoritetit Portual Durrës është në qytetin e Durrësit.

Neni 2
Objekti i statutit

Objekt i këtij statuti është përcaktimi i formës së organizimit, i rregullave të funksionimit dhe të administrimit, i marrëdhënieve me operatorët, me organet shtetërore dhe të përfaqësimit të Autoritetit Portual Durrës.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë statut termat kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 9130, datë 8.9.2003, “Për Autoritetin Portual”, ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 168/2013, datë 30.10.2013, “Për sigurinë në anije dhe në porte”, dhe në akte të tjera që normojnë veprimtarinë e portit në tërësinë e elementeve të infrastrukturës

së portit për realizimin e shërbimeve dhe të veprimtarisë portuale të transportit detar të mallrave dhe pasagjerëve.

Neni 4

Qëllimi i veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës

1. Autoriteti Portual Durrës është organi përgjegjës për zhvillimin dhe administrimin e infrastrukturës portuale në kompleksin portual dhe logjistik Durrës – Porto-Romano, sipas modelit të administrimit të integruar të disa porteve nën një autoritet të vetëm portual.

2. Qëllimi i veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës është:

a) të realizojë drejtimin administrativ të veprimtarisë në fushat e detarisë dhe të zonës detare përkatëse, si dhe të bashkërendojë marrëdhëniet me organet shtetërore;

b) të drejtojë dhe të kontrollojë ofrimin e shërbimeve portuale në kompleksin portual dhe logjistik Durrës – Porto-Romano dhe në portet e tjera tregtare ose turistike nën administrimin e tij;

c) të bëjë të frytshëm dhe më të orientuar në drejtim të ekonomisë së tregut autoritetin portual, të rrisë konkurrencën, të zhvillohet ekonomikisht përmes investimeve të drejtpërdrejta nga sektori privat për zvogëlimin e shpenzimeve publike dhe modernizimin e porteve;

ç) të shndërrojë portet që ka nën administrim dhe mbikëqyrje, nga “porte shërbimi” në “porte administruese toke” për të rritur pavarësinë e tyre tregtare;

d) të sigurojë zgjerimin, modernizimin dhe rehabilitimin e infrastrukturave portuale;

dh) të përafrojë shërbimet portuale me praktikat ndërkombëtare dhe standardet evropiane të fushës;

e) të sigurojë nivel shërbimesh të shkallës së lartë, në funksion të rritjes së vëllimeve tregtare dhe uljes së kohës së përpunimit të mallrave dhe pasagjerëve, me kosto të arsyeshme për transportin vendas dhe atë rajonal, veçanërisht drejt Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut;

ë) të garantojë një nivel të lartë sigurie dhe mbrojtje të mjedisit;

f) të mundësojë marrjen e masave për tranzicionin ekologjik të porteve nën administrimin e tij, në përputhje me praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare për transportin detar të gjelbër;

g) të sigurojë një shkallë të lartë autonomie për administrimin dhe zhvillimin e porteve, si dhe për operatorë të ndryshëm, që kryejnë shërbimet në to;

gj) të sigurojë qiradhënie ose koncesion, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontratat e qirasë dhe të legjislacionit në fuqi për koncesionet për disa pajisje të caktuara për veprimtarinë e portit;

h) të bashkërendojë veprimtarinë detare dhe sistemin e transportit, sipas legjislacionit në fuqi;

i) të bashkërendojë veprimtarinë e organeve shtetërore, subjekteve publike dhe private, që kryejnë veprimtarinë në një port nën administrimin e tij, të cilët nga ana e tyre kanë detyrimin për të respektuar të gjitha aktet ligjore e nënligjore në fuqi për organizimin dhe funksionimin e portit, duke përfshirë këtu edhe planin e administrimit të tokës dhe planin e sigurisë së portit dhe faciliteteve portuale;

j) të bashkojë pikat e forta dhe funksionet e specializuara të faciliteteve portuale nën administrimin dhe kompetencën e tij;

k) të krijojë një sistem unik portual nëpërmjet bashkëpunimit, koordinimit, me qëllim përgjigjen e shpejtë dhe fleksible ndaj nevojave të përdoruesve dhe ndjekjen e objektivave të përbashkët, për sa i takon performancës dhe mjedisit konkurrues rajonal;

l) të ndihmojë në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Infrastrukturave Pritëse e Shpërndarëse Portuale, me qëllim integrimin në nyjat kyçe të Bashkimit Evropian

dhe Evropës Juglindore, përmes Korridorit VIII dhe infrastrukturave ndërlidhëse energjetike, rrugore, hekurudhore dhe digjitale;

ll) të planifikojë burimet tokësore dhe financiare, duke promovuar intermodalitetin, me qëllim rritjen e vëllimeve të mallrave dhe pasagjerëve;

m) të mbështesë ndërtimin e terminaleve logjistike dhe zonave ekonomike tërheqëse për investimet e huaja, në funksion të rritjes së vëllimeve tregtare dhe vlerës së shtuar ekonomike në zonat portuale;

n) të mbështesë veprimtarinë e Forcës Detare (Roja Bregdetare) në ushtrimin e kompetencave dhe plotësimin e nevojave të tyre në zonat portuale përkatëse;

nj) të mbështesë Qendrën Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit për koordinimin e operacioneve të kërkim-shpëtimit në det, me qëllim minimizimin e pasojave në ambientin detar dhe eliminimin e humbjeve në jetët njerëzore.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës

1. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës është:

a) të administrojë tërësinë e hapësirave portuale në Durrës dhe në Porto Romano, përfshirë терминалет ekzistuese nën regjim koncesionar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe ato pasuri shtetërore dhe infrastruktura portuale që mund t'i kalojnë në administrim në të ardhmen, duke bashkërenduar veprimtaritë e mëposhtme:

i. veprimtaritë portuale për transportin e mallrave, lundrimin, drejtimin e anijeve, transportin e pasagjerëve, ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave, magazinimin e mallrave, që bëhen prej tij ose prej sektorit privat;

ii. veprimtarinë e ndërtimit, zhvillimit dhe modernizimit të infrastrukturës portuale që bëhet prej tij, enteve të tjera publike ose prej sektorit privat;

iii. veprimtari të tjera, të nevojshme për mbështetjen e veprimtarive të përshkruara më sipër.

b) të adresojë, të koordinojë, të rregullojë, të promovojë edhe përmes zyrave operacionale, administrative ose territoriale, kur është rasti, shërbimet portuale të ofruara nga operatorët e autorizuar dhe nga operatorët e tjerë të portit apo porteve pjesë të Autoritetit Portual Durrës;

c) të propozojë te ministri përgjegjës për portet shqiptare shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin e porteve detare në kompleksin portual dhe logjistik Durrës – Porto-Romano, si dhe në portet e tjera nën administrimin apo mbikëqyrjen e tij;

ç) të rregullojë, në koordinim me kapitenin e portit, hyrjen e mjeteve lundruese në kalatat dhe терминалет e porteve që ka në administrim dhe mbikëqyrje, si dhe të gjitha lëvizjet e mjeteve lundruese brenda tyre;

d) të hartojë dhe të realizojë strategji marketingu dhe tregtare;

dh) të propozojë shërbime dhe politika tarifore të harmonizuara;

e) të sigurojë hartimin e masterplaneve dhe projekteve të detajuara inxhinierike, në funksion të zgjerimit, modernizimit dhe rehabilitimit të infrastrukturave portuale;

ë) të këshillojë dhe të mbështesë ministrinë përgjegjëse për portet dhe institucione të tjera në lidhje me përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë evropian, praktikat më të mira evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe implementimin e tij për sa i përket shërbimeve dhe infrastrukturës portuale;

f) të sigurojë zhvillimin dhe zbatimin e sistemit të Dritares Detare Unike, në përputhje me praktikat më të mira evropiane e ndërkombëtare të fushës, duke bashkërenduar përpjekjet e agjencive shtetërore në këtë fushë;

g) të mundësojë integrimin e sistemeve dhe infrastrukturës *on-line* të përpunimit të anijeve, mallrave dhe pasagjerëve, duke promovuar inovacionin dhe automatizimin e proceseve të përpunimit në port;

gj) të mundësojë mbrojtjen kibernetike të infrastrukturave portuale kritike;

h) të monitorojë kontratat koncesionare, në të cilat APD-ja është palë apo e autorizuar, të miratuara në përputhje me legjislacionin në fuqi për koncesionet, me objekt veprimtarie transportin detar, shërbimet detare, përpunimin portual të mallrave dhe hidrokarbureve dhe raportimin periodik për autoritetet kontraktore përkatëse, bazuar në autorizimin apo delegimin e autoritetit kontraktor;

i) të propozojë për miratim te ministri përgjegjës për transportin detar, përcaktimin e terminaleve dhe kategoritë e përpunimit, sipas planeve të administrimit të tokës;

j) të miratojë lejet e përdorimit të portit nëpërmjet lejes, licensës ose autorizimit për subjektet që operojnë shërbime dytësore në zonat portuale;

k) të vendosë marrëdhënie financiare tregtare me subjektet e licencuara nga ministrinë, sipas fushave të përgjegjësisë për të operuar në port;

l) të sigurojë përshtatshmërinë e kërkesave për licensim pranë autoritetit kompetent të subjekteve, me objekt veprimtarie përpunimin e transportit të mallrave ose pasagjerëve që transportohen në rrugë detare;

ll) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave për themelimin e shoqërive tregtare ose entiteteve të tjera për ushtrimin e veprimtarive të veçanta;

m) të nxjerrë apo të propozojë akte rregullatore në fushën e sigurisë në punë në zonat portuale, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si edhe përcaktimet e këtij statuti;

n) të nxjerrë apo të propozojë rregulloret e nevojshme të shërbimeve portuale;

nj) mund të krijojë zyra operationale, administrative ose territoriale pranë porteve nën juridiksionin e tij, me qëllim koordinimin, mbikëqyrjen, monitorimin e veprimtarisë portuale, në përputhje me kompetencat e Autoritetit Portual Durrës;

o) të programojë, të planifikojë, të projektojë dhe të realizojë kurse të formimit profesional për punonjësit që operojnë në hapësirat portuale, si dhe të lëshojë dëshmi të aftësive mbi bazën e këtyre programeve, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

p) të propozojë rregullore në fushën e aftësimit të drejtuesve të makinerive portuale;

q) të realizojë detyra të tjera, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si edhe përcaktimet e këtij statuti.

Neni 5/1

(Shtuar me VKM nr. 351, datë 13.5.2026)

1. Autoriteti Portual Durrës ka të drejtën ekskluzive për të realizuar veprimtari portuale për ngarkim-shkarkimin dhe përpunimin e kontejnerëve në kompleksin portual e logjistik Durrës – Porto-Romano dhe në portet e tjera tregtare ose turistike nën administrimin e tij. Kjo e drejtë ekskluzive ushtrohet drejtpërdrejt nga Autoriteti Portual Durrës nëpërmjet një shoqërie tregtare të krijuar posaçërisht për këtë qëllim, ose nëpërmjet një operatori të tretë të kontraktuar, sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

2. Autoriteti Portual Durrës ushtron të drejtën e parashikuar në pikën 1 të këtij neni për ofrimin e shërbimeve të ngarkim-shkarkimit dhe përpunimit të kontejnerëve në kompleksin portual dhe logjistik Durrës – Porto-Romano dhe në portet e tjera tregtare ose turistike nën administrimin e tij, vetëm në një nga rastet e mëposhtme:

a) Kur ekziston nevoja e dokumentuar e interesit publik, duke përfshirë sigurinë kombëtare, integritetin e infrastrukturës kritike portuale ose garantimin e pandërprerë të

shërbimeve strategjike të transportit detar;

b) Kur kapaciteti fizik i terminaleve të kontejnerëve në kompleksin portual e logjistik Durrës – Porto-Romano është i kufizuar dhe nuk lejon operimin e disa operatorëve, referuar planeve të administrimit të tokës, të miratuara sipas këtij statuti.

3. Ofrimi i shërbimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, qoftë nëpërmjet shoqërisë tregtare të ngritur për këtë qëllim, apo një operatori të tretë të kontraktuar, lejohet vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme njëkohësisht:

a) Sigurohet ndarja e plotë funksionale, kontabël dhe financiare ndërmjet veprimtarisë rregullatore e administruese të Autoritetit Portual Durrës dhe veprimtarisë tregtare të ofrimit të shërbimeve, sipas standardeve të kontabilitetit të ndarë, të njohura ndërkombëtarisht;

b) Shmangët çdo konflikt interesi ndërmjet rolit rregullator dhe atij operacional të Autoritetit Portual Durrës, sigurohet transparenca e plotë në vendimmarrje dhe zbatohen mekanizma të pavarur të monitorimit dhe ankimit, të aksesueshëm për të gjithë operatorët portualë;

c) Respektohen plotësisht rregullat e konkurrencës e të monitorimit të veprimtarisë së operatorit ekskluziv, sipas legjislacionit në fuqi, duke garantuar trajtim jodiskriminues ndaj operatorëve privatë të licencuar.

4. Kushtet, kriteret dhe procedurat e hollësishme për verifikimin e veprimtarisë portuale për ngarkim-shkarkimin e kontejnerëve, tarifatat e zbatueshme dhe procedurën e vlerësimit të pavarur, të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi për rregullat e funksionimit dhe të administrimit të Autoritetit Portual Durrës.

5. Në rastet e ofrimit të shërbimit nga subjekte të treta, kriteret e dhënies së koncesionit përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për koncesionet.

Neni 6

Pasuria e Autoritetit Portual Durrës

1. Autoriteti Portual Durrës ushtron kompetencën e tij tokësore dhe detare në të gjitha zonat portuale dhe në infrastrukturën përkatëse, duke përfshirë, por pa u kufizuar, kanalet hyrëse, dallgëthyesit, basenet, kalatat, pontilet, vendbregëzimet, rrugët dhe hekurudhat.

2. Autoriteti Portual Durrës gëzon të drejtat e administrimit të pronave shtetërore, të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë portuale, të kaluara nën administrim të tij, si dhe të entiteteve të krijuara apo të zotëruara prej tij, me vendime të posaçme të Këshillit të Ministrave dhe çdo të drejtë të lidhur me to, duke respektuar strukturën e organizimit, si “port administrues toke”.

3. Pasuria e Autoritetit Portual Durrës përbëhet nga pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, nën përgjegjësi administrimi të Autoritetit Portual Durrës, ku përfshihen:

a) të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme që ka nën përgjegjësi administrimi të tij apo shoqërive tregtare të krijuara ose të zotëruara prej tij;

b) të gjitha pasuritë e paluajtshme që përbëjnë terminale logjistike në tokë, porte të thata, nën administrimin e tij, si dhe çdo infrastrukturë tjetër që i kalohet në përgjegjësi administrimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pronat e paluajtshme të shtetit.

4. Pasuria e Autoritetit Portual Durrës përbëhet edhe nga pasuritë e luajtshme të trashëguara, sipas vendimit nr. 596, datë 10.9.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij”.

5. Autoriteti portual nuk mund të shesë apo të lërë garanci asnjëherë nga pronat shtetërore që administron, por mund:

a) të ofrojë lehtësi, të japë të drejta ose leje dhe autorizime për shërbimet ose të krijojë mundësi për t’i përdorur ato, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

b) të shesë pajisjet dhe të hartojë dokumentacionin e kërkuar për atë qëllim;

c) të sigurojë territoret tokësore dhe ujore për zgjerimin e porteve, për t'i ardhur në ndihmë veprimtarisë së tyre.

Neni 7

Organet drejtuese

1. Organet drejtuese të Autoritetit Portual Durrës, janë:
 - a) Këshilli Drejtues;
 - b) Drejtoria Ekzekutive.
2. Organet e Autoritetit Portual Durrës ndihmohen dhe këshillohen nga Këshilli Konsultativ i Portit.

Neni 8

Përbërja dhe emërimi i këshillit drejtues

1. Përbërja e këshillit drejtues të Autoritetit Portual Durrës është, si më poshtë vijon:
 - a) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për portet shqiptare;
 - b) një përfaqësues nga ministria përfaqësuese e pronës shtetërore;
 - c) një përfaqësues nga institucioni i Prefektit Durrës;
 - ç) një përfaqësues nga Bashkia Durrës;
 - d) dy përfaqësues nga sektori privat, të propozuar nga këshilli konsultativ i portit.Këshilli konsultativ i portit mund të propozojë më shumë se 2 persona, por ministri përgjegjës për portet shqiptare emëron 2 (dy) prej kandidatëve.
2. Anëtarët e këshillit drejtues duhet të kenë një përvojë pune në transport mbi pesë vjet, të kenë njohuri e përvojë të gjerë për menaxhimin e biznesit në operacionet e portit ose në marinën tregtare, si dhe
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të jetë i diplomuar në ciklin e dytë të studimeve universitare apo i përzgjedhur si personalitet i njohur në fushën e tij profesionale;
 - c) të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, për të cilën nuk është rehabilituar apo kundërvajtje administrative për evazion fiskal, shkelje të dispozitave të Kodit Doganor ose të veprimtarisë në port;
 - ç) të mos ketë marrë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar, sipas legjislacionit në fuqi;
 - d) të mos ketë konflikt interesash me detyrën, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi;
 - dh) të jetë rezident në Shqipëri;
 - e) të mos jetë kontraktues i një përdoruesi të portit ose personi që është drejtor, nëpunës apo i punësuar i kontraktuesit të përdoruesit të autoritetit portual;
 - ë) të mos ketë detyrime falimenti të papërbushura.
3. Të gjithë anëtarët emërohen nga ministri përgjegjës për portet shqiptare, me propozim të institucioneve përkatëse.
4. Anëtarët e këshillit drejtues emërohen për një afat jo më shumë se 3 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Anëtarët e këshillit drejtues kanë statusin e punës me kohë të pjesshme.
5. Mbledhja e këshillit drejtues zhvillohet me më shumë se gjysmën e anëtarëve të këtij këshilli. Në rast largimi të anëtarëve të këshillit drejtues, zëvendësimi i tyre bëhet në përputhje me parashikimet e këtij neni.

6. Këshilli drejtues, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh me shumicë votash kryetarin dhe zëvendëskryetarin. Kryetari, si rregull, zgjidhet nga përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për portet shqiptare.

7. Këshilli drejtues përcakton pagesën e anëtarëve, të kryetarit dhe të drejtorit ekzekutiv, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Përgjegjësia e anëtarëve të këshillit drejtues dhe të nëpunësve

1. Çdo anëtar i këshillit drejtues dhe nëpunës i Autoritetit Portual Durrës, gjatë ushtrimit të përgjegjësisë dhe kryerjes së detyrës duhet:

- a) të veprojë me ndershmëri dhe përgjegjësi në interes të autoritetit portual;
- b) të jetë profesionist në realizimin e detyrave;
- c) të ndjekë hap pas hapi objektivin e kthimit të portit në një “port administrues toke”, zbatimin e legjislacionit për autoritetin portual dhe rregullat e këtij statuti;
- ç) të sigurojë përdorimin e mundësive dhe të rrisë shfrytëzimin maksimal të portit për të plotësuar kërkesat e klientit dhe të tregut;
- d) të realizojë shpërndarje të drejtë të burimeve njerëzore, teknike dhe financiare të portit;
- dh) të respektojë rregullat e përcaktuara në legjislacionin e punës, si dhe në Kodin Etik të Sjelljes;
- e) të njohë mirë rregullat e legjislacionit detar, në përgjithësi dhe veçanërisht, legjislacionin për autoritetin portual dhe aktet e dala në bazë e për zbatim të tyre.

Neni 10

Papajtueshmëria me postin e anëtarit të këshillit drejtues

1. Anëtar i këshillit drejtues nuk zgjidhet personi që:
 - a) nuk është shtetas shqiptar;
 - b) nuk është rezident në Shqipëri;
 - c) është kontraktues i një përdoruesi të Autoritetit Portual Durrës ose personi që është drejtor, nëpunës apo i punësuar i kontraktuesit të përdoruesit të këtij autoriteti portual;
 - ç) ka qenë i dënuar për vepra penale apo kundërvajtje administrative për evazion fiskal, shkelje të dispozitave të Kodit Doganor ose të veprimtarisë në port;
 - d) është përjashtuar nga shërbimi civil;
 - dh) ka konflikt interesash me detyrën;
 - e) nuk ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga falimentimi.

Neni 11

Largimi nga detyra

1. Ministri përgjegjës për portet shqiptare largon nga detyra anëtarin e këshillit drejtues kur:

- a) e shkarkon nga detyra për arsye se:
 - i. nuk vepron në përputhje me kërkesat e përgjegjësisë së anëtarëve të këshillit drejtues, të përcaktuara në ligjin “Për Autoritetin Portual” dhe rregullat e parashikuara në këtë statut;
 - ii. kryen vepra penale ose shkelje të dispozitave të Kodit Doganor dhe të veprimtarisë në port.
- b) e liron nga detyra kur:
 - i. jep dorëheqjen me shkrim;

- ii. i kufizohet zotësia për të vepruar ose humb jetën;
 - iii. i mbaron mandati;
 - iv. konstatohen kushte të papajtueshmërisë me postin e anëtarit të këshillit drejtues;
 - v. mbush moshën për daljen në pension pleqërie.
2. Në rastin e nënparagrafit “v”, të pikës 1, të këtij neni, kur anëtari i këshillit drejtues mbush moshën për daljen në pension pleqërie, ministri ka të drejtë ta lërë të vazhdojë funksionin e tij deri në mbarimin e mandatit, sipas kërkesës së anëtarit të këshillit drejtues, në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 12

Detyrat dhe të drejtat e këshillit drejtues

1. Këshilli drejtues është organi i vetëm përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së Autoritetit Portual dhe ushtron të drejtat mbi pronën si “port administrues i pronës”.
2. Këshilli drejtues harton, ndryshon dhe shfuqizon rregulloret e brendshme dhe vendimet që rregullojnë ecurinë e autoritetit portual.
3. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës dhe miraton planin strategjik të auditimit të brendshëm.
4. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës miraton marrjen e kredisë apo huas për qëllime të portit. Propozimi i marrjes së kredisë apo huas diskutohet paraprakisht nga këshilli konsultativ i portit.
Autoriteti Portual Durrës nuk mund të hipotekojë apo të lërë si garanci pronën shtetërore që menaxhon apo administron. Garanci mund të lihet vetëm nga të ardhurat e kësaj prone.
5. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës merr vendime, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për miratimin e lidhjes së kontratave të huadhënies apo huamarrjes me Autoritetit Portual Durrës dhe subjekteve të treta tregtare.
6. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës, pasi merr mendimin e komisioneve teknike, financiare dhe të këshillit konsultativ të portit përcakton kriteret të qarta të dhënies së koncesionit, në përputhje me legjislacionin për koncesionet. Çdo rast, procedura e koncesionit bëhet në përputhje me legjislacionin e posaçëm për koncesionet.
7. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës për arritjen e objektivave në investime të miraton masa të nevojshme për të investuar me fondet e veta apo fondet e buxhetit të shtetit të miratuar për ministrinë përkatëse në zgjerimin, modernizimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës portuale.
8. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës nuk mund të shesë asnjërin nga pronat shtetërore që administron, por mund:
 - a) të ofrojë lehtësi, të japë të drejta ose leje për shërbimet ose të krijojë mundësi për t’i përdorur ato, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.;
 - b) të shesë pajisjet dhe të hartojë dokumentacionin e kërkuar për këtë qëllim;
 - c) të sigurojë territoret tokësore dhe ujore për zgjerimin e portit për t’i ardhur në ndihmë portit.
9. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës cakton tarifat, për:
 - a) anijet, mjetet e transportit dhe personat që përdorin portin;
 - b) ngarkimin e mallrave në anije, shkarkimin e tyre, tregtimin detar, brenda kufijve të portit ose magazinimin në port;
 - c) shërbimet që sigurohen nga Autoriteti Portual Durrës ose nga një operator i autorizuar ose për ndonjë të drejtë të dhënë prej tij në lidhje me portin;

Tarifat me propozimin e Autoritetit Portual Durrës miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrisë përgjegjëse për portet shqiptare dhe të ministrisë përgjegjëse për financat.

10. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës cakton normën e interesit që kërkohet për pagesat e vonuara.

11. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës aprovon planbiznesin e Autoritetit Portual Durrës me të dhënat e përcaktuara në ligjin “Për Autoritetin Portual”, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për portet shqiptare.

12. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës miraton pasqyrat financiare të vitit fiskal pararendës, në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, të shoqëruara me raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

13. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës miraton strukturën dhe organigramën e Autoritetit Portual Durrës.

14. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës përcakton pagesën dhe strukturën e pagave të Autoritetit Portual Durrës, sipas legjislacionit në fuqi, me miratimin e ministrit përgjegjës për portet shqiptare.

Neni 13

Mbledhja e këshillit drejtues

1. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës, si rregull, mbledhet, jo më pak se një herë në tre muaj.

2. Mbledhjet e këshillit drejtues të Autoritetit Portual Durrës, si rregull bëhen me prezencë fizike, por në raste të veçanta mund të zhvillohen me pjesëmarrje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, përfshirë komunikimin video dhe audiokonferencë.

3. Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e kryetarit do të jetë vendimtare.

4. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës zhvillon mbledhjen vjetore, jo më vonë se një muaj pas mbylljes së llogarive të Autoritetit Portual, për miratimin e pasqyrave financiare të vitit fiskal pararendës, në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, të shoqëruara me raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

5. Mbledhjet vjetore të autoritetit portual janë të hapura për publikun dhe çdo mbledhje tjetër që gjykohet prej tij.

6. Autoriteti Portual Durrës bën njoftimin në një nga gazetatat kryesore në vend ose në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Portual Durrës, të paktën 30 ditë përpara mbledhjes, ku përcakton orën dhe vendin ku do të mbahet mbledhja dhe krijon mundësinë që pasqyrat financiare t’u vihen në dispozicion pjesëmarrësve.

7. Në mbledhjen vjetore, këshilli drejtues siguron:

a) numrin e mjaftueshëm të kopjeve të pasqyrave financiare të autoritetit portual për personat e pranishëm në mbledhje;

b) që drejtori ekzekutiv dhe anëtarët e këshillit drejtues t’u përgjigjen pyetjeve të pjesëmarrësve për veprimtarinë e Portit Durrës.

8. Këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës është përgjegjës për mbajtjen në libra të posaçëm të procesverbaleve të mbledhjeve të tij.

Neni 14

Emërimi i drejtorit ekzekutiv

1. Këshilli drejtues emëron drejtorin ekzekutiv dhe zëvendësin e tij, mbi bazën e propozimit të ministrit përgjegjës për portet shqiptare.

2. Drejtori ekzekutiv emëron nëpunësit e tjerë dhe personelin e nevojshëm për menaxhimin e portit.
3. Drejtori ekzekutiv nuk është anëtar i këshillit drejtues.

Neni 15

Marrëdhëniet ndërmjet këshillit drejtues dhe drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv është përgjegjës përpara këshillit drejtues për drejtimin dhe administrimin e Autoritetit Portual Durrës. Ai bashkërendon punën për planifikimin dhe caktimin e burimeve të të ardhurave të departamenteve dhe të njësive të tjera.

Neni 16

Përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv dhe marrëdhëniet me nëpunësit

1. Përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv, janë:
 - a) Siguron drejtimin dhe administrimin efektiv të portit;
 - b) Zhvillon, zbaton dhe realizon veprimtaritë e përcaktuara nga ligji “Për Autoritetin Portual”, si dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij;
 - c) Përgatit dokumentacionin e autoritetit portual për burimet njerëzore dhe i administron këto burime;
 - ç) Përfaqëson autoritetin portual në ministrinë përgjegjëse për portet shqiptare dhe në marrëdhënie me të tretë;
 - d) Siguron zbatimin e politikave të Autoritetit Portual Durrës dhe të kërkesave të tjera ligjore për këtë autoritet;
 - dh) Nxit rritjen e nivelit dhe profesionalizmin në anëtarët e stafit të tij;
 - e) Siguron të dhëna për këshillin drejtues për çështjet që lidhen me autoritetin portual dhe vë në dijeni këshillin drejtues për këto çështje dhe politikat që lidhen me to;
 - ë) Kontribuon në hartimin e politikave që synojnë rritjen e frytshme të autoritetit portual dhe vë në dijeni këshillin drejtues për këto politika;
 - f) Zbaton detyrat e tjera, të caktuara nga këshilli drejtues.
2. Drejtori ekzekutiv është menaxheri i përgjithshëm i Autoritetit Portual Durrës dhe vepron sipas autoritetit të deleguar nga këshilli drejtues, duke i raportuar drejtpërdrejt atij.
3. Nëpunësit e njësive të tjera janë përgjegjës përballë drejtorit ekzekutiv.
4. Drejtori ekzekutiv zbaton politika për forcimin e autoritetit portual dhe përgjegjësi, qartëson stafin për nivelin e punës së tyre dhe kryen detyrat publike, duke ruajtur mirëbesimin, integritetin dhe profesionalizmin e shërbimeve të kryera, të drejtën e publikut për t’u informuar lidhur me aktivitetin e portit.
5. Drejtori ekzekutiv, në mbështetje të kërkesave, i jep leje për të hyrë në port çdo personi që ushtron veprimtari në port.
6. Drejtori ekzekutiv gjithashtu, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mëposhtme:
 - a) Veprimtarinë portuale për transportin e mallrave, lundrimin, drejtimin e anijeve, transportin e pasagjerëve, ngarkim-shkarkimin e mallrave, magazinimin e mallrave, që bëhen prej tij ose prej sektorit privat;
 - b) Veprimtari të tjera, të nevojshme për mbështetjen e veprimtarive të mësipërme.
7. Drejtori ekzekutiv lidh kontrata në emër të autoritetit portual.
8. Drejtori ekzekutiv, në emër të Autoritetit Portual Durrës, në çdo mbledhje vjetore që organizohet, sipas detyrimeve që përcakton ligji “Për Autoritetin Portual”, lidhur me veprimtarinë ekonomiko-financiare të këtij autoriteti, është i detyruar të paraqesë:
 - a) pasqyrat financiare krahasuese;

- b) raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;
 - c) çdo të dhënë tjetër për pozitën financiare të autoritetit portual.
9. Drejtori ekzekutiv, në emër të Autoritetit Portual Durrës, i paraqet ministrit përgjegjës për portet shqiptare pasqyrat financiare të miratuara nga këshilli drejtues dhe është i detyruar t'i raportojë atij për veprimtarinë ekonomiko-financiare.
10. Drejtori ekzekutiv propozon strukturën e organizimit të Autoritetit Portual Durrës dhe strukturën e pagave, e cila miratohet nga këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës dhe nga ministri përgjegjës për portet shqiptare.
11. Drejtori ekzekutiv nëpërmjet urdhrave dhe udhëzimeve ushtron veprimet e administrimit të veprimtarisë së Autoritetit Portual Durrës, të përcaktuara nga ligji “Për Autoritetin Portual”, si dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij.
12. Drejtori ekzekutiv ka të drejtën të shqyrtojë ankesat e ndryshme për dallime në vendosjen e tarifave. Ai është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga depozitimi i ankesës.
13. Drejtori ekzekutiv i Autoritetit Portual Durrës, në zbatim të ligjit “Për Autoritetin Portual”, ka të drejtë të shqyrtojë ankesat kundër gjobave për kundërvajtje administrative të vëna nga agjentët kontrollues në bazë të ligjit të mësipërm, të paraqitura brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit. Ai është i detyruar ta shqyrtojë ankesën brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

Neni 17

Këshilli konsultativ

Autoriteti Portual Durrës, në këshillim me ministrin përgjegjës për portet shqiptare, krijon një këshill konsultativ me 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, përfaqësues nga sektori privat dhe shtetëror, që kanë ndërveprim me aktivitetin portual dhe detar, ku shumicën e zë sektori privat, i cili këshillon Autoritetin Portual Durrës, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, “Për Autoritetin Portual”.

Neni 18

Librat e llogarive dhe sistemet

1. Autoriteti Portual Durrës mban librat e llogarive, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin “Për Autoritetin Portual”, si më poshtë vijon:
 - a) ruan librat e llogarive dhe të raporteve llogaritëse;
 - b) siguron kontrollin financiar dhe menaxherial, përmes sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, duke garantuar dhe përditësimin e tyre, sa herë që ndryshojnë kushtet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 2. Librat e llogarive, regjistrimet, sistemet dhe praktikat mbahen dhe përpunohen në mënyrë që të japin garanci se:
 - a) aktivet e autoritetit portual janë të siguruara dhe të kontrolluara;
 - b) veprimet e autoritetit portual janë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - c) burimet njerëzore, financiare dhe fizike të autoritetit portual janë menaxhuar në mënyrë të frytshme dhe se operacionet e këtij autoriteti janë kryer realisht.
 3. Autoriteti Portual Durrës mban një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së tij, në pajtim me kërkesat ligjore, dhe sigurohet që menaxhimi i aktiveve të investuara të jetë efektiv dhe i kujdesshëm.
- Në mbylljen e vitit ushtrimor financiar, Autoriteti Portual Durrës harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar dhe përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen gjatë vitit ushtrimor financiar.

4. Subjektet portuale publike apo private që operojnë me asete të Autoritetit Portual Durrës kanë detyrimin të përdorin sistemet elektronike të inventarizimit të aktiveve të autoritetit portual në mënyrë që të jenë të siguruara dhe kontrolluara.

5. Subjektet portuale publike apo private të licencuara, që përdorin infrastrukturën portuale apo asete të Autoritetit Portual Durrës për të përmbushur shërbimet e përcaktuara në kontratë ose licencë kanë detyrimin t'i nënshtrohen tarifave portuale.

6. Çdo operator portual publik apo privat, institucione qendrore apo vendore, agjenci ligjzbatuese, që ushtrojnë aktivitetin në territorin, nën përgjegjësi administrimi nga Autoriteti Portual Durrës, kanë detyrimin të përdorin apo të shkëmbejnë informacion nëpërmjet sistemeve të komunitetit portual të implementuara nga autoriteti portual.

Neni 19

Kontrolli i Autoritetit Portual Durrës

1. Organet shtetërore që kanë objekt të veprimtarisë së tyre kontrollin e organeve publike ushtrojnë kontroll mbi Autoritetin Portual Durrës, sipas kompetencave respektive për të përcaktuar nëse veprimet e tij, janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Organet e kontrollit, në përfundim të kontrollit, u paraqesin këshillit drejtues dhe ministrit përgjegjës për portet shqiptare një raport për përfundimet e kontrollit dhe masat e sugjerimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për përmirësimin e punës, kur këto janë të domosdoshme.

3. Autoriteti Portual Durrës i nënshtrohet dhe kontrollit të auditit të brendshëm të tij, si dhe kontrollit që ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, që përzgjidhet me procedurë konkurruese dhe që kryejnë misionin e tyre, në pajtim me ligjin.

Neni 20

Planet e administrimit dhe përdorimit të tokës

1. Autoriteti Portual Durrës harton planin e administrimit të tokës (*masterplan*) të hollësishëm, i cili përmban objektivat dhe politikat për zhvillimin material të pronave shtetërore që administron. Hartimi ose rishikimi i një plani për administrimin e tokës, mbështetet në ligjet në fuqi dhe në standardet ndërkombëtare. Planet duhet të përmbajnë dispozitat për rishikime, nëse një gjë e tillë kërkohet nga ndryshimet e strategjisë së zhvillimeve të porteve.

2. Planin e administrimit të tokës (*masterplan*), me propozim të ministrit përgjegjës për portet shqiptare, miratohet nga strukturat përgjegjëse për miratimin e *masterplan*-eve.

3. Autoriteti Portual Durrës harton planet e përdorimit të porteve, të cilët miratohen nga këshilli drejtues i Autoritetit Portual Durrës, bazuar në planet e administrimit të tokës dhe përcaktojnë llojin dhe kategoritë e aktiviteteve të lejueshme dhe ato të ndaluara në portin apo facilitetin portual përkatës.

4. Autoriteti Portual Durrës përcakton terminalët e përpunimit të mallrave, përfshirë terminalët logjistike në tokë, porte të thata nën administrimin e tij, brenda ose jashtë vendit, kategoritë e përpunimit, të cilët miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për portet shqiptare.

Neni 21

Rregullimi i lëvizjeve brenda porteve

APD-ja planifikon dhe përcakton kalatën e akostimit të anijeve dhe të gjitha mjeteve lundruese të tjera, të cilat hyjnë në portet dhe terminalët nën administrim dhe mbikëqyrje të

Autoritetit Portual Durrës, në përputhje me rregulloret e APD-së, profilin e terminalit ku do të operohet, bazuar në informacionin për mallin dhe anijen, gjendjen teknike të faciliteteve portuale, kohën e përpunimit, si dhe duke marrë në konsideratë nevojën e anijes për shkarkimin e mbeturinave dhe furnizimet e nevojshme.

Neni 22

Tarifat

1. Tarifat portuale për portet, nën administrim dhe mbikëqyrje të Autoritetit Portual Durrës, përcaktohen me propozimin e Autoritetit Portual Durrës dhe me miratimin e ministrisë përgjegjëse për portet shqiptare dhe të ministrisë përgjegjëse për financat.

2. Tarifat portuale, të caktuara nga Autoriteti Portual Durrës, duhet të jenë në nivel që i lejojnë atij të veprojë në baza vetëmbështetëse financiare dhe ato duhet të jenë të arsyeshme dhe të favorshme njëkohësisht për autoritetin dhe operatorët portualë.

3. Autoriteti Portual Durrës cakton tarifat për:

- a) anijet, mjetet e transportit dhe personat që përdorin portin;
- b) ngarkimin e mallrave në anije, shkarkimin e tyre, tregtimin detar, brenda kufijve të portit ose magazinimin në port;
- c) shërbimet që sigurohen nga autoriteti portual ose nga një operator i autorizuar ose ndonjë të drejtë të dhënë prej tij, në lidhje me portin, si dhe për efekt të mirëmbajtjes së infrastrukturës të lidhura për to;

4. Kur tarifat portuale janë propozuar nga një operator që punon në port, Autoriteti Portual Durrës, pas këshillimit me këshillin konsultativ të portit, cakton një kufi tavan të këtyre tarifave. Tarifat portuale tavan, të propozuara nga Autoriteti Portual Durrës, sipas kësaj pike, nuk duhet të rrezikojnë arritjet ekonomike dhe financiare të operuesit.

5. Autoriteti Portual Durrës cakton normën e interesit që kërkon për pagesat e vonuara.

6. Kur cakton tarifat, Autoriteti Portual Durrës nuk i lejohe të shkelë barazinë e subjekteve përdoruese. Nuk përbën diskriminim apo shkelje të barazisë, nëse bëhen dallime në bazë të vëllimit të mallrave apo të sasisë së të mirave që tregtohen ose mbi baza të tjera, që nga ana tregtare janë të pranueshme.

7. Tarifat portuale këshillohen me këshillin konsultativ të portit dhe i nënshtrohen konsultimit publik, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

8. Udhëzimi i ministrive përgjegjëse për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 23

Shërbimet portuale kryesore

1. Shërbimet portuale kryesore përfshijnë çdo lloj veprimtarie që lidhet me mbërritjen dhe nisjen e mjeteve lundruese, si dhe me lëvizjen e pasagjerëve e të mallrave, brenda dhe jashtë porteve.

2. Shërbimet portuale kryesore kryhen nga subjekte publike ose private të licencuara.

3. Autoriteti Portual Durrës, në cilësinë e drejtuesit dhe kontrolluesit të shërbimeve portuale, vendos marrëdhënie tregtare e financiare me subjektet e licencuara nga ministritë, sipas fushave të përgjegjësisë për të operuar në port, si dhe subjektet që gëzojnë një autorizim apo leje për të operuar në hapësirën portuale nën administrimin e Autoritetit Portual Durrës.

Neni 24

Shërbimet portuale jokryesore

1. Shërbimet portuale jokryesore përfshijnë çdo lloj veprimtarie tjetër të aktiviteteve tregtare dhe ofrimi i shërbimeve nga subjekte fizike apo juridike, që lidhen me veprimtaritë dhe shërbimet kryesore tregtare në Autoritetin Portual Durrës.

2. Autoriteti Portual Durrës, në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit të zbatueshëm dhe rregullave të përcaktuara nga këshilli drejtues, drejton, kontrollon dhe përcakton rregullat për ofrimin e shërbimeve dhe ushtrimin e veprimtarive jokryesore në portet, nën administrim dhe mbikëqyrje nga Autoriteti Portual Durrës, duke pajisur me lejet dhe autorizimet përkatëse çdo operator, kur ky i fundit provon në mënyrë të kënaqshme se plotëson kriteret, sipas parashikimeve ligjore.

Autorizimit i nënshtrohen dhe veprimtaritë e uljes, ngritjes, mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve lundruese të ankoruara në kalata, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

3. Autoriteti Portual Durrës, në cilësinë e drejtuesit dhe kontrolluesit të shërbimeve portuale, lidh kontratë me këta operatorë, duke bërë përcaktimin e marrëdhënies financiare të Autoritetit Portual Durrës.

Neni 25

Mbështetja e autoritetit kompetent për licencimet

Autoriteti Portual Durrës, në cilësinë e drejtuesit dhe kontrolluesit të shërbimeve portuale, siguron përshtatshmërinë e kërkesave për licencim pranë autoritetit kompetent të subjekteve, me objekt veprimtarie përpunimin e transportit të mallrave ose pasagjerëve që transportohen në rrugë detare

Neni 26

Masat për kundërvajtjet dhe e drejta e ankimit

1. Dënimet me gjobë të kundërvajtjeve, sipas përcaktimeve të neneve 45 dhe 46, të ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003, "Për Autoritetin Portual", vendosen nga agjentët kontrollues, të caktuar nga drejtori ekzekutiv.

2. Kundër dënimit administrativ me gjobë bëhet ankim te drejtori ekzekutiv, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.

3. Drejtori ekzekutiv është i detyruar ta shqyrtojë ankesën dhe të kthejë përgjigje brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e ankimit.

4. Kundër vendimit të drejtorit dhe në rastin kur ai nuk përgjigjet brenda afatit të caktuar, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e dhënies së dënimit administrativ.

Neni 27

Shërbimi i sigurisë në anije dhe në port

1. Autoriteti Portual Durrës, për të siguruar personat nga rreziku për jetën dhe plagosja e për të siguruar materialet nga dëmtimi ose humbja në portet e Shqipërisë, krijon Forcën e Sigurisë Portuale Durrës (FSPD) dhe cakton stafin e nevojshëm, bazuar në kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Autoriteti Portual Durrës, në varësi të rritjes së vëllimit të punës, ka të drejtë të rrisë ose të pakësojë numrin e punonjësve të FSPD-së.

2. FSPD-ja regjistron të gjitha aksidentet e ndodhura dhe zbaton rregulloret dhe udhëzimet e hartuara sipas legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe sistemet e praktikave të pranura nga shteti shqiptar për mbrojtjen e personave dhe të materialeve në port.

3. FSPD-ja e zhvillon veprimtarinë në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Sigurisë së Anijeve dhe Porteve, të Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), me Konventën SOLAS, të ndryshuar, me ligjin “Për sigurinë në anije dhe porte”, dhe me aktet e tjera nënligjore në fuqi.

4. Detyrat e shërbimit të sigurisë përfshijnë, por pa u kufizuar:

- a) mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës të objekteve dhe vlerave të portit;
- b) krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të përshtatshëm për Autoritetin Portual Durrës dhe operatorët e ndryshëm në të gjitha terminalët logjistike në tokë, porte të thata, nën administrimin apo monitorimin e tij, brenda ose jashtë vendit, për një punë 24-orëshe me tri turne;
- c) përgatitjen e rregulloreve të sigurisë për transportimin, lëvizjet ose magazinimin e eksplozivëve a të substancave të tjera që përbëjnë rrezik për jetën dhe pronën;
- ç) përgatitjen e planeve dhe të rregullores së sigurisë për personat dhe mjetet e transportit në port;
- d) sugjerimet për përgatitjen e planit të biznesit dhe të planit të përdorimit të tokës.

5. Drejtori i FSPD-së është në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit ekzekutiv të Autoritetit Portual Durrës dhe përgjigjet para tij për të gjithë veprimtarinë e sigurisë në port dhe në anijet e ankoruara, në lëvizje nga dhe në drejtim të portit, në radë, si dhe vepron në përputhje me udhëzimet e drejtorit ekzekutiv.

6. FSPD-ja i paraqet nëpërmjet drejtorit ekzekutiv, këshillit drejtues çdo vit një raport për problemet e sigurisë.

7. Përcaktimi i kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes FSPD-së përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për portet shqiptare.

8. FSPD-ja pajiset me uniformë të veçantë dhe është e pajisur me armatimin dhe mjetet e nevojshme, për të siguruar mbrojtjen e portit dhe të anijeve nga çdo sulm i mundshëm, terrorist apo keqbërës ose nga hyrja, në mënyrë të kundërligjshme, e shtetasve dhe e mjeteve në zonën, që ka objekt kontrolli.

Pajisjet, mjetet dhe armatimi i lejuar janë armë tipit pistoletë, shkop zgjatues dhe mbajtës, mjete transporti dhe patrulluese tokësore dhe lundruese, mjetet e ndërlidhjes radiostacionare VHF, radio dore VHF.

9. FSPD-ja, kur, gjatë ushtrimit të veprimtarisë vëren kryerjen e një vepre penale, njofton strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit dhe të Prokurorisë, si dhe bashkëpunon me ta për ndalimin e autorëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu, FSPD-ja kur vëren shkelje apo shmangie nga detyrimet doganore, i raporton menjëherë degës së doganave, Durrës.

10. Rregullorja e brendshme e FSPD-së, pas aprovimit të Autoritetit Shtetëror të Sigurisë Portuale dhe këshillit drejtues të Autoritetit Portual Durrës, miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për portet shqiptare.

Neni 28

Bashkërendimi i detyrave me komitetin e sigurisë

1. Komiteti i sigurisë në anije dhe në portet e hapura, nën përgjegjësi administrimi dhe mbikëqyrje të APD-së, i ngritur sipas ligjit nr. 9281, datë 23.9.2004, “Për sigurinë në anije dhe në porte”, vlerëson projektplanet e sigurisë dhe bashkërendon punën me palët operuese në port për zbatimin e këtyre planeve.

2. Autoriteti Shtetëror i Sigurisë apo Autoriteti Portual Durrës, në rast se e vlerësojnë të nevojshme, mund të kërkojnë mbledhjen e komitetit të sigurisë në çdo kohë.

3. Autoriteti Portual Durrës siguron dhe koordinon integrimin e sistemeve të sigurisë portuale, sisteme, në të cilat kanë detyrimin për tu integruar të gjithë agjencitë e zbatimit të

ligjit dhe institucionet që ushtrojnë detyrat, sipas kompetencave në territoret e Autoritetit Portual Durrës.

Neni 29

Shërbimi i mbrojtjes së mjedisit

1. Autoriteti Portual Durrës për mbrojtjen e mjedisit në port, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe për lejet mjedisore krijon shërbimin e kualifikuar të mbrojtjes së mjedisit dhe ndan përgjegjësitë e përcakton detyrat e këtij shërbimi.

2. Shërbimi i mbrojtjes së mjedisit regjistron të gjitha rastet e veprimeve që cenojnë mjedisin dhe zbaton rregulloret, vendimet dhe udhëzimet e Autoriteti Portual Durrës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, me sistemet dhe praktikën e pranuar nga shteti shqiptar për mbrojtjen e mjedisit dhe të tokës së portit.

3. Detyrat e shërbimit të mbrojtjes së mjedisit përfshijnë, por pa u kufizuar:

a) garantimin, monitorimin e cilësisë së mjedisit ujor dhe në tokë të portit, duke përfshirë mekanizmat e kontrollit apo inspektimit për operatorët portualë të licencuar dhe nënkategorive të tjera;

b) hartimin e planeve të kontingjencës, si dhe të rregulloreve për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja gjatë transportimit, lëvizjes ose magazinimit të substancave që përbëjnë rrezik për mjedisin;

c) pjesëmarrjen në përgatitjen e planit të biznesit dhe të planit të përdorimit të tokës.

4. Nëpunësi i mbrojtjes së mjedisit, si rregull, çdo vit, por edhe për çdo rast ndotjeje, i paraqet këshillit drejtues një raport të hollësishëm për problemet mjedisore të portit.

5. Personeli i shërbimit të mbrojtjes së mjedisit dhe i shërbimit të sigurisë, të emëruar nga autoriteti portual, duhet të bashkërendojnë detyrat e tyre me Kapitenerinë e Përgjithshme të Porteve dhe me organizmat e tjerë, rajonalë ose kombëtarë, përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit dhe për sigurimin industrial.

6. Nëpunësi i mbrojtjes së mjedisit dhe nëpunësi i sigurisë janë përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit dhe të sigurisë në zonën tokësore, ndërsa kapiteni i portit është përgjegjës për zonën ujore të portit dhe për anijet.

7. Nëpunësi i mbrojtjes së mjedisit është pjesë e procedurave të konsultimit bashkë me institucionet e tjera përgjegjëse para, gjatë, apo pas licencimit të veprimtarive me ndikim në mjedis në territorin tokësor ose operatorët portualë që licencohen, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 30

Shërbimi i mbikëqyrjes së sigurisë dhe shëndetit në punë

1. Autoriteti Portual Durrës siguron shërbimin e mbikëqyrjes për garantimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë nga vetë punonjësit nga operatorët portualë dhe nga kontraktorët e tij.

2. Ky shërbim mund të realizohet nga ekspertë të punësuar ose të kontraktuar nga autoriteti portual dhe të ngarkuar me kryerjen e detyrave, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë.

3. Detyrat e shërbimit të mbikëqyrjes së sigurisë dhe të shëndetit në punë përfshijnë, por pa u kufizuar:

a) garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, formimit të punëmarrësve të Autoritetit Portual Durrës;

b) marrjen e masave që mund të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi sigurinë dhe shëndetin në punë;

c) dhënien e ndihmës së parë, mbrojtjen kundër zjarrit dhe evakuimin e punëmarrësve;

ç) dhënien e informacionit për vlerësimin e rreziqeve, masat mbrojtëse, regjistrin dhe raportet e aksidenteve në punë, si dhe raportet nga inspektoratet ose institucionet përgjegjëse për sigurinë e shëndetin në punë;

d) hartimin e planit dhe organizimin e trajnimeve;

dh) sigurimin që punëmarrësit e Autoritetit Portual Durrës të jenë të pajisur me lejet e ushtrimit të profesioneve, të cilat parashikohen me akte ligjore të veçanta;

e) sigurimin e funksionimit të vazhdueshëm dhe të duhur të sistemeve dhe mjeteve mbrojtëse, mjeteve të matjes dhe të kontrollit, si dhe të pajisjeve të diktimit, mbajtjes nën kontroll dhe neutralizimit të substancave të rrezikshme, që çlirohen gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike;

ë) vënien në dispozicion të inspektorëve të punës gjatë inspektimit ose hetimit të ngjarjeve, dokumentacionin e nevojshëm dhe informacionin e kërkuar;

f) bërjen e rregullimeve të nevojshme për të realizuar masat, që kërkojnë nga inspektorët e punës gjatë inspektimeve ose hetimeve të ngjarjeve;

g) bashkërendimin e punës me kontraktorët e portit dhe operatorët portualë:

i. për zbatimin e dispozitave për sigurinë, higjienën dhe shëndetin, duke pasur parasysh natyrën e veprimtarisë së punës;

ii. për mbrojtjen dhe parandalimin e rreziqeve profesionale, duke siguruar që çdo operator apo kontraktor të caktojë një koordinator për sigurinë dhe shëndetin në punë;

iii. për shkëmbimin reciprok të informacioneve për këto rreziqe, për të cilat duhen vënë në dijeni punëmarrësit përkatës ose përfaqësuesit e tyre.

gj) kryerjen e një vlerësimi të rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve të autoriteti portual, përfshirë edhe për grupet e operatorëve ose kontraktorëve të ekspozuar ndaj rreziqeve të veçanta;

h) përcaktimin e masave mbrojtëse që duhen marrë dhe, nëse është e nevojshme, pajisjet mbrojtëse që do të përdoren;

i) mbajtjen e regjistrit të aksidenteve në punë, për rastet kur punëmarrësit përfitojnë paaftësi të përkohshme në punë, për më shumë se 3 (tri) ditë pune, për shkak të aksidenteve e të sëmundjeve profesionale;

j) hartimin e raporteve për aksidentet në punë e sëmundjet profesionale, të cilat ia vë në dispozicion autoriteteve përkatëse;

k) detyrime të tjera për punëdhënësin që parashikon ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë.

4. Shërbimi i mbikëqyrjes për garantimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe me Inspektoratin Sanitar Shtetëror.

5. Autoriteti Portual Durrës ushtron kontroll pranë operatorëve portualë dhe kontraktorëve të tij, me qëllim garantimin prej tyre të sigurisë dhe shëndetit në punë në zonat portuale përkatëse, si dhe i propozon këshillit drejtues ose ministrit përgjegjës rregullore, të cilat përcaktojnë kriteret për garantimin dhe sigurinë e shëndetit në punë gjatë kryerjes së operacioneve portuale, riparimit dhe mirëmbajtjes së anijeve në hapësirën portuale.